



Në bazë të nenit 11, të Udhëzimit Administrativ – Aktivitetet jashtëshkollor nr. 02/2016, të dt 12.01.2016, dhe në vendimin nr. Prot. 113 : të datës 20.03.2018, KDSH, - Gjimnazi "Jeta e re" në Suharekë, shpall:

## FTESË PËR OFERTË – Nr. 01/2018

**Ftojme të gjitha agjencitë turistike të bëjnë ofertë për ekskursionin e maurantëve të Gjimnazit "JETA E RE" në Suharekë**

Ekskursioni do të zhvillohet në Republikën e Shqipërisë ndërmjet datave 24 prill – 04 maj 2018.

Kohëzgjatja e ekskursionit është 5 (pesë) pansione të plota.

Në ekskursion do të marrin pjesë 449 nxënës.

Në ofertë të parashihet çmimi i akomodimit, ushqimit, transportit dhe shpenzimet e ndryshme që paraqiten me rastin e vizitave në muze dhe kala që parashihen në rrugëtimin e ekskursionit të përcaktuar nga Këshilli drejtues i shkollës.

Agjencionet turistike që konkurojnë duhet t'i plotësojnë këto parakushte:

1. Agjencioni duhet të ketë lejen e punës dhe të jetë i licencuar me të drejtë qarkullimi jashtë shtetit – Ofertës t'i bashkëngjiten fotokopjet e këtyre dokumenteve (të vërtetuara të Noteri).
  2. Të ketë bërë kontrollin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore – Ofertës t'i bashkëngjiten dëshmitë për këtë për të gjithë autobusët që do të përdoren në ekskursion.
  3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e ekskursionit.
  4. Për tërë personat e angazhuar në ekskursion nga agjencioni (shofer dhe kondukter) duhet të paraqiten certifikatat e mjekut.
  5. Agjencioni duhet të siguron përkujdesje mjekësore për pjesëmarrësit e ekskursionit gjatë tërë kohëzgjatjes së tij. Ofertës t'i bashkëngjiten leja e punës e mjekut dhe fotokopja e kontratës me të, për përkujdesje gjatë tërë kohëzgjatjes së ekskursionit.
  6. OE i kërkohet të bëjë një konfirmim me shkrim që do të jetë në gjendje të menjanon shpejtë prishjet eventuale të ndonjë autobusi ose nëse është e nevojshme pa vonesë ta zëvendëson atë.
  7. Te ofron dëshminë për rezervimin e hapësirave hoteliere në Durrës
  8. Të ketë rrethojë, dhe siguri nga personeli i sigurimit të hotelit
  9. Licencën e agjencionit të akreditimit të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve.
  10. Hoteli të posedoj licencën e sallës për argëtim, me hapësirë të mjaftueshme dhe pa pije alkoolike.
  11. Gjatë vizitave nëpër monumente të sigurohet pagesa hyrëse sipas itinerarit të përcaktuar nga KDSH.
- Dokumentet jashtë afatit të paraparë nuk pranohen.
  - Dokumentet jo-komplete nuk shqyrtohen.
  - Përparësi në përzgjedhje do të kenë Operatorët, të cilët kanë ofertat më të kompletuara, numër të mjaftueshëm të autobusëve të Kompanisë dhe ofertojnë brenda çmimit të preferuar nga KDSH.
  - Afati i konkurimit 7 ditë pune nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
  - Dorëzimi i ofertave bëhet deri më 30.03.2018 në ora 14.00, në zyrën pritëse të Komunës për DKA - Gjimnazi "JETA E RE" në Suharekë.
  - Hapja e ofertave bëhet me datë 30.03.2018 në ora 15.00 në Gjimnazin "JETA E RE" në Suharekë.
  - Formulari i Paraqitjes së Ofertës dhe Rrugëtimi i ekskursionit i hartuar nga Këshilli i drejtues i shkollës merren në Gjimnazin "JETA E RE" në Suharekë nga data 21.03.2018.

Suharekë, më 21.03.2018

Drejtori: Lira Mala

Rr.: "Parku i Dëshmorëve" 23000 Suharekë, Kosovë  
Tel. 029/271 261, e-mail: [gjetaere@hotmail.com](mailto:gjetaere@hotmail.com)

